



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS

GJAKOVA



Zyra e Kryetarit të Komunës së Gjakovës në bazë të neni 8 paragrafi 3.2, të rregullores 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, shpall këtë :

THIRRJE PUBLIKE

Për dy përfaqësues nga grupi i Ekspertëve të jashtëm, një nga OJQ dhe një Ekspert për komisionin vlerësues.

Zyra e Kryetarit të Komunës së Gjakovës, ka bërë hapjen e Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ-ve në fushën e profilizuar të të drejtave digjitale, të publikuar me datë: 12.06.2026 me titull:

Thirrje publike për mbështetje financiare për projektet e OJQ-ve në fushën e profilizuar të të drejtave digjitale

Zyra e Kryetarit të Komunës së Gjakovës, fton të gjithë të interesuarit të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues, si ekspert të jashtëm ose përfaqësues të OJQ-ve, që të aplikojnë të jenë pjesë e komisionit.

Kandidatët e interesuar duhen t'i plotësojnë këto kritere, të cilat ndikojnë në përzgjedhje si më poshtë:

1. Përvoja në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike (20 pikë);
2. Përvoja në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike (10 pikë);
3. Njohja e dokumenteve strategjik dhe politikave prioritare në fushën e thirrjes publike (15 pikë);
4. Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat që mbulon thirrja publike (10 pikë);
5. Njohja e metodologjive ekzistuese brenda fushës së thirrjes publike (20 pikë);
6. Njohja e dokumenteve të tjera relevante në fushën në të cilën është hapur thirrja publike (10 pikë);
7. Njohja e gjuhës së institucioneve kryesore dhe qëllimit të tyre të punës në fushat në të cilat është hapur thirrja publike (15 pikë).

Afati i aplikimit: 22.06.2026 deri 30.06.2026

Kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë këto kritere:

Duhet të kenë diplomë universitare;

Të kenë përvojë në hartimin e projekteve brenda fushës së thirrjes publike.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në adresën: Rr. "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e Kryetarit të Komunës së Gjakovës.